



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 91 Prot.

Tiranë 11 / 08 / 2023

Lënda: Ftesë për pjesëmarrje si anëtar zëvendësues në Komisionin e Pavarur Ad Hoc për verifikimin dhe vlerësimin paraprak të kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatisë

Drejtuar: Z. Sokol Puto
Avokat

Dhoma e Avokatisë
Rruga "Murat Toptani"
Tiranë

I nderuar z. Puto!

Bazuar në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ju informojmë se më datë 19.07.2023 Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka publikuar shpalljen e vendeve vakante dhe thirrjen për paraqitjen e shprehjes së interesit për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Anëtarë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga rradhët e avokatëve.

Avokati i Popullit ka nisur punën për ndjekjen dhe zbatimin e procedurave të nevojshme administrative për zhvillimin e procesit, në përputhje me kompetencat dhe afatet e percaktuara në ligjin e sipërcituar.

Për rrjedhojë, në përmbushje të detyrimeve që rrjedhin nga neni 23 dhe 25 i ligjit nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, Avokati i Popullit i kërkoi zyrtarisht Dhomës së Avokatisë dërgimin e listës së avokatëve që plotësojnë kriteret e percaktuara ligjore për anëtar të Komisionit të Pavarur Ad Hoc. Theksojmë se Dhoma e Avokatisë sipas ligjit ka pasur kompetencë vetëm identifikimin e avokatëve që plotësojnë kriteret e percaktuara, përpilimin e listës dhe dërgimin e saj pranë Avokatit të Popullit.

Në vijim të kësaj kërkesë, Dhoma e Avokatisë i ka komunikuar Avokatit të Popullit listën e avokatëve që plotësojnë kriteret e percaktuara ligjore së bashku me të dhënat e tjera personale. Pas shqyrtimit të kësaj liste, si dhe në zbatim të pikës 2, të nenit 25 të ligjit të sipërcituar, Avokati i Popullit ftoi fillimisht z. Fatmir Braka, që në cilësinë e avokatit më të vjetër në moshë, të shërbente si anëtar në Komisionin e Pavarur Ad Hoc.

Përmes komunikimit elektronik, z. Braka konfirmoi se për arsye personale dhe familjare nuk pranon të jetë anëtar i Komisionit të Pavarur Ad Hoc. Në këto kushte, në përputhje me procedurat e parashikuara nga dispozita e sipërcituar, Avokati i Popullit vijoi të kryejë të njëjtën procedurë me kandidatët që pasojnë në listë, sipas kriterit të moshës, duke ftuar z. Maksim Haxhia në cilësinë e avokatit të dytë më të vjetër në moshë, që të shërbejë si anëtar në Komisionin e Pavarur Ad Hoc.

Pas ftesës së bërë nga Avokati i Popullit, z. Haxhia konfirmoi disponibilitetin për të qënë anëtar i Komisionin e Pavarur Ad Hoc. Për rrjedhojë, duke qënë se dispozita e sipërcituar parashikon që dhe caktimi i anëtarit zëvendësues ndjek të njëjtën procedurë dhe në bazë të të njëjtit kriter, Avokati i Popullit ju fton që të shërbeni si anëtar zëvendësues në Komisionin e Pavarur Ad Hoc.

Ju lutemi verifikoni, për sa në dijeninë tuaj, kushtet e neneve 28 dhe 29 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe konfirmoni disponibilitetin tuaj për ushtrimin e kësaj detyre.

Ju bëjmë me dije gjithashtu se mbledhjet e Komisionit të Pavarur Ad Hoc parashikohet të zhvillohen fizikisht pas datës 22.08.2023. Ndërkohë, gjatë kësaj periudhe komunikimi për çështje që lidhen me procesin do të jetë në formë elektronike.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

Me respekt.

AVOKATI I POPULLIT

Erinda BALLANCA

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Fatbardh Zenelaj

